



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

TË DHËNA MBI VENDIMIN Nr. 110 Datë 19.11.2018

SHQYRTIM RAPORTI AUDITIMI

Autoriteti kontraktor	Bashkia Korçë dhe 6 ish Komunat Drenovë, Vithkuq, Voskop, Lekas, Mollaj dhe Bulgarec
Organi auditues	Kontrolli i Lartë i Shtetit
Numri i procedurave të audituara	8
Lloji i procedurës/ave të audituara	“E hapur”, “Kërkesë për propozim”.
Konstatimet kryesore	<p>1. Autoriteti kontraktor ka vepruar në kundërshtim me nenin 28, pika 3, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, lidhur me argumentimin dhe dokumentimin e përlogaritjes së fondit limit, në disa procedura prokurimi të audituara.</p> <p>2. Autoriteti kontraktor ka vepruar në kundërshtim me nenin 46 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, lidhur me hartimin e kritereve të veçanta të kualifikimit, në përputhje me natyrën dhe përmasat e objektit të prokurimit, sa i takon kryesisht kategorive të kërkuara të licencave profesionale, në disa procedura prokurimi të audituara.</p> <p>3. Autoriteti kontraktor ka vepruar në kundërshtim me nenin 53, pika 3, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, lidhur me kualifikimin e operatorëve pjesëmarrës, në pjesën më të madhe të procedurave të prokurimit të audituara.</p> <p>4. Autoriteti kontraktor ka vepruar në kundërshtim me Kreun VII, pika 2, të VKM Nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, të ndryshuar (në</p>

	fuqi në kohën e zhvillimit të procedurës) sa i takon nënshkrimit të kontratës me njërin prej dy anëtarëve të bashkimit të operatorëve fitues, në dy procedura prokurimi të audituara.
Masat e marra	<p>1. Në bazë të nenit 72, pika 1 dh/g, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar (në fuqi në kohën e zhvillimit të procedurave të audituara), APP vendosi të dënojë me gjobë 12 persona të evidentuar përgjegjës për mospërmbushje të detyrimeve të përcaktuara në nenet 28 dhe 53 të këtij ligji.</p> <p>2. Në bazë të nenit 72, pika 2, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar (në fuqi në kohën e zhvillimit të procedurave të audituara), APP vendosi të propozojë marrjen e masës disiplinore për 11 persona të evidentuar përgjegjës për mangësi të konstatuara në vendim.</p>